



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Prahuja e dëgjave	07 - 03 2025		
Nr. e Dokumentit	Numer	Emri	Të dhëna
		Erasmus+	
	509		



Erasmus+

Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime e Universitetit Publik “Kadri Zeka”, në Gjilan,

shpall këtë:

**Thirrje për aplikim për shkëmbim të stafit
në Universitetin “Çukurova University”Adana,
Turqi**

Universiteti Publik “Kadri Zeka”, është pjesë e projektit KA171 ICM, 2022-2027, Erasmus+, në partneritet me Universitetin e Çukurova University, Adana, Turqi.

Programi Erasmus + KA171 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i stafit (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit të Çukurova University nga Turqia dhe Universitetit “Kadri Zeka”, në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e stafit nga Universiteti “Kadri Zeka” – Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fusha të ndryshme, ku në këtë thirrje do të kenë mundësi që një(1) staf nga UKZ të realizojnë mobilitetin në Universitetin e Çukurova.

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti sipas Distance Caluculator të Erasmus +:

<https://erasmus-plus.ec.europa.eu/resources-and-tools/distance-calculator>

Granti i udhëtimit do të paguhet pas lëvizjes nga projektit dhe mbulohet nga Universiteti pritës.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.



APLIKIMI DHE PËRZGJEDHJA

Kriteret për aplikim për stafit janë:

Të jeni mësimdhënës i irregullt në UKZ apo në rast të stafit administrativ të keni kontratën valide të punës në UKZ.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kontrata e punës(që dëshmon që jeni staf i irregullt i UKZ-së, apo staf administrativ);
- CV në Gjuhën Angleze(ku janë të përmendura edhe punimet shkencore, si dhe të arriturat e tjera dhe përvaja e punës);
- Kopje e pasaportës(facja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënrat personale) osc letërnjoftimit;
- Një letër motivimi(në gjuhën angleze);
- Kërkohet njohuri e gjuhës angleze e dëshmuar;

Përzgjedhja bëhet:

- Në bazë të fushës së përafërt të ligjërit me fushat e ofruara nga Universiteti pritës dhe fusha juaj e veprimit në UKZ 50%;
- Gjuhë e huaj 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

1. Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike), prej datës **07.03.2025 deri më 14.03.2025**. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.
2. Në këtë thirrje do të pranohet një(1) staf nga UKZ. Të drejtë aplikimi kanë vetëm stafi akademik.
3. Të gjithë aplikantët duhet të sigurojnë dëshminë/certifikatën e gjuhës angleze: niveli C1 për stafin akademik dhe B1 për stafin administrativ.
4. Aplikantët të cilët kanë qenë pjesë e mobilitetit në të kaluarën nuk kanë përparësi ndaj aplikantëve që aplikojnë për herë të parë në thirrje të këtij lloji (ata do të kuotohen me pikë negative nga komisioni).
5. Formularin e aplikimit e gjeni në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime të cilin e plotësoni gjatë dorëzimit të dokumenteve tjera të kërkua.
6. Rezultatet e aplikimit do të shpallojnë www.uni-gjilan.net.

Për çdo informacion shtesë, kontaktoni Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Anëtarësime në UKZ.

Me respekt,

Prof. Dr. Dukagjin Leka
Prorektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte